ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MIN.E BUJQËSISË,PYLLTARISË DHE ZHVILL. RURAL**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **203-23-11410-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Blerja e tabletave për inspektor te AZHB-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**Pattern SH.P.K.**
NUI	**811976903**
Adresa	**Rruga Ruzhdi Shabani, nr 47**
Vendi	**Lipjan**
Kodi postar	**14000**
Numri Telefonit	**049 570 110**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Granit Zeqiri**
Adresa elektronike	**patternshpk@yahoo.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**21.12.2023**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Blerja e tabletave për inspektor te AZHB-së

Aktiviteti i prokurimit është publikuar me 18.10.2023

Dorëzimi i ofertave është bërë më 08.11.2023

Vendimi i AK-së është marrë me 05.12.2023

Kerkesa për Rishqyrtim 07.12.2023

Pergjigjje në Kërkesën për Rishqyrtim 11.12.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka marrë parasysh kërkesën tonë për rishqyrtim përkundër argumenteve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e

Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

2.Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

4.Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veproj në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-së

Mungon certifikata ISO Mund të kërkohen informata sqaruese

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ashtu sic e kemi cekur edhe në Kërkesën për Rishqyrtim Autoriteti Kontraktues MPBZHR duke shpërblyer me kontratë kompaninë ARITECH SHPK ka shkelur LIGJI Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Autoriteti Kontraktues MPBZHR tek dosja e tenderit konkretisht në aneksin 1 Specifikat teknike të detyrueshme ka kërkuar që OE të ngarkoj një certifikat të kualitetit, në këtë rast OE ARITECH SHPK nuk ka ngarkuar një certifikat të tillë por një ‘’ Deklaratë të Konformitetit për UK, konkretisht për Mbretërin e Bashkuar.

Certifikata e Kualitetit nuk ka ekuivalencë me ‘’ Deklaratë të Konformitetit për UK’’ dhe rrjedhimisht AK ka pranuar një document i cili nuk është sipas kërkesave të cilat vet i ka përcaktuar gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe përmes këtij dokumenti OE ARITECH SHPK nuk ka arritë të tregoj për kualitetin e produktit pasi kjo deklaratë paraqet diçka tjeter. Edhe sikur kjo deklaratë të kishte të bënte me kualitetin e paisjeve, AK perseri me shperblimin me kontratë të OE ARITECH SHPK bënë shkelje pasi produktet qe janë ofertuar janë për tregun e UK përkatësisht Mbretërin e Bashkuar, si dhe e kanë spinin e rrymës të Mbretërisë së Bashkuar e cila nuk është me standarde të Europës dhe nuk gjen përdorim në tregun e Europës, dëshmi për këtë keni foton e spinit të rrymës të Mbretërisë së Bashkuar.

Autoriteti Kontraktues MPBZHR ka shkelur nenin 72 dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK duke mos kërkuar informacione shtesë tek ne si OE me ofertën e dytë me të volitshme në këtë aktivitet prokurimi bazuar në udhezuesin për prokurim public si më poshtë:

Mungon certifikata ISO Mund të kërkohen informata sqaruese, Certificata ISO mund të

jetë një certifikatë e kualitetit dhe është ekuivalente dhe mos kërkimi i infomatave sqaruese bazuar në nenin 72 dhe UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, me këtë veprim AK bën shkelje tjetër **Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve pika 2 dhe pika 4.**

Ne bazë të asaj qe u tha me lartë dhe argumenteve të prezantuara kerkojm që të anulohet vendimi i Autoriteti Kontraktues MPBZHR për shperblim me kontratë OE ARITECH SHPK dhe lënda të kthehet në rivlersim

.

UK Declaration of Conformity

We, Microsoft Corporation, declare under our sole responsibility that the Portable Computing Device, Mode (marketing name: Surface Pro X), equipped with power supply model 1706 (not covered by this declaration) essential requirements and other relevant requirements of the following legislation of the UK:

- *Statutory Instrument 1206 Radio Equipment Regulations 2017 (as amended)*
- *Restriction of the Use of Certain Hazardous Substances in Electrical and Electronic Equipment Regulations*

The following designated standards and technical specifications have been applied:

- *EN 300 328, V2.2.2*
- *EN 300 440, V2.1.1*
- *EN 301 489-1, V2.2.3**
- *EN 301 489-17, V3.2.4**
- *EN 301 893, V2.1.1*
- *EN 50566: 2017*
- *EN 55032: 2015/A11:2020**
- *EN 55035: 2017/A11:2020**
- *EN 62368-1:2014/A11: 2017**
- *EN IEC 63000: 2018*

** not a designated standard*

Supplementary information:
Software/Firmware that impacts Essiential Compliance: N/A
Accessories that impact Essiential Compliance: N/A

Manufacturer:
Microsoft Corporation
One Microsoft Way
Redmond, WA 98052-6399
United States

August 18, 2021

Hasnain Syed
Senior Director, EMC/SI&RF Compliance

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Sigurimi i tenderit, kosto e stafit për përpilimin e ofertës, kërkesa per rishqyrtim si dhe Ankesa.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*